



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 6.07.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

Për projektligjin

“Për një shtesë në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datës 3.07.2018 dhe 6.07.2018, shqyrtoi në parim, nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”. Procedura e shqyrtimit të projektligjit u mbështet në nenet 32-39, të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjet e komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të komisionit ishte e pranishme Zv. Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Z. Ervin Bushati.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në nenet 78, 83 pika 1, 113, pika 1 shkronja “ç”, 155 dhe 157 të Kushtetutës dhe miratimi i tij i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji parashikon shtimin e një pike në nenin 27 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë” të ligjit ekzitues, duke kërkuar përjashtimin nga pagesa e kësaj takse të subjekteve të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse, të certifikuar si agroturizëm sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 2, të ligjit 93/2015 “Për turizmin”, të ndryshuar.

Përmes ligjit nr. 106/2017, date 30.11.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, u miratua përjashtimi nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë e investimeve të kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”. Duke qënë se në këtë kategori të strukturave pritëse akomoduese nuk përfshihet veprimtaria pritëse e licensuar për agroturizëm, qëllimi i Këshillit të Ministrave përmes këtij projektligji është pikërisht përfshirja në skemën e përjashtimit nga taksa e ndikimit në infrastrukturë edhe e investimeve në infrastrukturë të subjekteve që zhvillojnë veprimtari pritëse, të certifikuara si agroturizëm, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave që miraton kriteret për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit.

IV. Diskutimet në komision

Gjatë prezantimit të projektligjit, Zv. Ministri i Financave dhe Ekonomisë, shpjegoi nismën e Qeverisë në ndihmë të agroturizmit dhe evidentoi faktin se kjo nismë do të shërbejë si një stimul i mëtijshëm për zhvillimin e këtij sektori krahas stimujve të tjerë fiskal që janë miratuar në vazhdimësi.

Gjithashtu u evidentuar fakti se ndryshimi është konsultuar në shkallë të gjerë edhe me grupet e interesit dhe shoqatat e bizneseve në vend. Ai vjen në përputhje me strategjinë e zhvillimit rural pjesë e programit katër vjeçar të kësaj Qeverie, e cila synon diversifikimin e aktiviteteve ekonomike jobujqësore në zonat rurale.

Relatori i çështjes gjatë diskutimit në parim, vuri theksin në faktin se Qeveria shqiptare është angazhuar në krijimin e hapësirave dhe mekanizmave nxitës që zonat rurale të mos jenë ekskluzivisht bujqësore në ekonominë e tyre, por të nxiten edhe forma të tjera zhvillimi. Ky angazhim është përfshirë edhe në programin e integruar të zhvillimit të qendrave të banuara, zonave rurale me interes turistik dhe synon përmirësimin e infrastrukturës, vlerësimin e traditave dhe trashëgimisë kulturore, rritjen e nivelit të shërbimeve publike, që i jep mundësi zonave të caktuara rurale të kenë një trend pozitiv zhvillimi ekonomik, të diversifikuar dhe të qëndrueshëm, duke krijuar njëherazi edhe premisat për agroturizmit.

Përfundimi nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe e investimeve në infrastrukturë për strukturat akomoduese të certifikuara si agroturizëm është në linjë edhe me përjashtimin e bërë nga kjo taksë për strukturat akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, të miratuara në dhjetor të vitit të shkuar.

V. Përfundime

Përfundimisht, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke vlerësuar se projektligji është hartuar në shërbim të interesit publik dhe në përputhje me politikat e qeverisë për krijimin e lehtësira për biznesin prodhues e uljen e barrës fiskale e miratoi projektligjin në parim, nën për nen dhe në tërësi me ndryshimin e mëposhtëm

Në nenin 1 të projektligjit, pika 8 e shtuar në nenin 27 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, riformulohet si më poshtë:

“8. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilët zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.”

Relator

Ervin BUSHATI

Kryetar

Erion BRAÇE